

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AMITIÉ” SHPK**

**KREU I**  
**Pjesa e përgjithshme**

Ky statut i hartuar sot më datë 12.07.2021, akti i themelimit dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë marrëdhëniet midis ortakëve të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “AMITIÉ” SHPK.

**KREU II**  
**Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakëve**

**NENI 1**  
**Emri**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “AMITIÉ”.  
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**  
**Forma**

Shoqëria tregtare “AMITIÉ”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**  
**Zyra Qendrore**

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “AMITIÉ” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga “K.Kazanxhi”, nr. 16, nr. pasurie 2/347-N2, Durrës, Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**  
**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt aktiviteti Atelier (Rrobaqepsi/Stilim) prodhim dhe shitje veshjesh, aksesorësh mode dhe tekstilesh, me shumicë dhe pakicë; organizim eventesh mode.

**NENI 5**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**  
**Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

Shoqëria tregtare “AMITIÉ” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**  
**Përgjegjësia e Ortakëve**

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “AMITIÉ” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

### KREU III

## **Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit**

### NENI 8

#### **Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat**

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "AMITIÉ" SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Ortaku Alda Mehmetaj, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë;
- Ortaku Ariola Likometa, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë.

### NENI 9

#### **Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar**

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

### NENI 10

#### **Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar**

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

10.2 Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosi ndryshe.

### NENI 11

#### **Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar**

11.1 Kuotat e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve, ortakë ose jo ortakë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me kushtëzimet e mëposhtme:

- Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshirojnë të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë.  
Ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij ia ofron atë ortakëve të tjerë nëpërmjet administratorit.  
Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.  
Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, ortakët e tjerë duhet të përgjigjen për ushtrimin e të drejtës së parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej saj. Në rast se ortakët që do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes janë më shumë se një, kuota ndahet ndërmjet tyre në pjesë të barabarta.
- Në rast se ortakët nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshirojnë të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë atëherë kjo e drejtë mund të ushtrohet nga vetë shoqëria.  
Ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij ia ofron atë shoqërisë.  
Shoqëria ka të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, shoqëria duhet të ushtrojë të drejtën e parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ajo ka hequr dorë prej saj.

Në rast se shoqëria vendos ta ushtrojë të drejtën e parablerjes ajo duhet të autorizojë administratorin për të blerë kuotën dhe të vendosë anulimin e saj. Në këtë rast, shoqëria duhet të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vlerën nominale të kuotës së anuluar. Si pasojë e këtij zvogëlimi të kapitalit do të ndryshojë edhe raporti i pjesëmarrjes në kapital të ortakëve të shoqërisë.

- Në rast se ortaku që tjetëron kuotën e vet, ia shet atë një të treti jashtë shoqërisë, me çmim dhe kushte më të favorshme nga ato që ua ka ofruar ortakëve dhe shoqërisë për efekt të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata e shitjes që ortaku do të lidhë me personin e tretë do të jetë e pavlefshme dhe shoqëria nuk do të japë miratimin për këtë kalim.

11.2 Të gjitha njoftimet në funksion të zbatimit të këtij neni do të bëhen nëpërmjet postës elektronike (email).

#### **KREU IV**

#### **Organet e Shoqërisë**

#### **NENI 12**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

#### **NENI 13**

#### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- anulimin e kuotave;
- largimin ose përjashtimin e ortakut;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo nga ky statut.

#### **NENI 14**

#### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

14.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

14.3 Asambleja e Përgjithshme thirret në respektim të parashikimeve të neneve 83 dhe 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Njoftimi për mbledhje duhet të dërgohet jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

14.4 Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të postës elektronike. Adresat elektronike ku do të dërgohen komunikimet janë: [mehmetaj.aldal@gmail.com](mailto:mehmetaj.aldal@gmail.com), [ariola1993@outlook.com](mailto:ariola1993@outlook.com). Dërgimi i njoftimit në këto adresa do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht. Ndryshimi i këtyre adresave do të duhet ti njoftohet administratorit.

14.5 Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

14.6 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në zyrën qendrore (selinë) të shoqërisë ose dhe online nëpërmjet videokonferencës për faktin se ortakët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Konfirmimi për zhvillimin e mbledhjes online dërgohet në adresën elektronike të administratorit. Për zhvillimin e mbledhjes online, duhet të jenë pro ortakët të cilët përfaqësojnë 51% të kapitalit të shoqërisë.

#### **NENI 15**

#### **Pjesëmarrja në Vendime**

15.1 Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjesëtim me kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.

15.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

15.3 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga Administratori.

#### **NENI 16**

#### **Kuorumi**

16.1 Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, për çështje të zakonshme, janë të vlefshme nëse të marrin pjesë personalisht ose të përfaqësuar, ortakët të cilët zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast, për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me 51% të votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

16.2 Për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të cilësuar, si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, anulimi i kuotës së kapitalit, largimi i ortakut, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me  $\frac{3}{4}$  e votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje. Mbledhja në këtë rast konsiderohet e vlefshme nëse marrin pjesë personalisht ose të përfaqësuar, në mbledhje, ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.

16.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 17.1, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 17**

#### **Procesverbali i Mbledhjes dhe Vendimet**

17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.

17.2 Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverbalit, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit.

17.3 Procesverbalit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

17.4 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme nënshkruhen nga ortakët e shoqërisë. Në rastin kur mbledhja zhvillohet online vendimi i Asamblesë hartohet dhe i dërgohet ortakëve nga Kryetari i Mbledhjes nëpërmjet email. Ortakët e nënshkruajnë atë me firmë elektronike dhe ia nisin aktin e nënshkruar nëpërmjet postës elektronike administratorit dhe ortakëve të tjerë.

#### **NENI 18**

#### **Administratori**

18.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

18.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 2 vjet me të drejtë ripërtëritje.

18.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të shoqërisë. Ai ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët; të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe të depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit; punësimin dhe pushimet nga puna të personelit; dhënien e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në shoqëri; mbajtjen e korrespondencës së shoqërisë; dhënien e autorizimit për blerjen, marrjen me qira etj. të mallrave apo shërbimeve të zakonshme të cilat lidhen në mënyrë direkte apo të tërthortë me punën e përditshme të shoqërisë; autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tërheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e shoqërisë lidhur me pagat apo shpërblimet e punonjësve të shoqërisë; Të përpilojë dhe të nënshkruajë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të shoqërisë si rezultat i punëve të kryera; Të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë (Euro, Lekë dhe USD) të Shoqërisë, pranë çdo banke ku ndodhen këto llogari, deri në një vlerë prej 10,000 Euro (dhjetë mijë euro) ose ekuivalenti i kësaj shume në monedha të tjera, për çdo transaksion, qoftë ky i tërë apo i fraksionuar.

18.4 Për administrimin e zakonshëm të shoqërisë të përcaktuar në nenin 18.3, Asambleja e Përgjithshme me vendim të posaçëm, një herë në vit, përcakton shumën limit me të cilën Administratori mund të kryejë veprimet e sipërcituara, nëse vlera e përcaktuar në këtë nen do të ndryshojë.

18.5 Për administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë, e cila do të kalojë kompetencat e përcaktuara në nenin 18.3 dhe shumën limit mbi të cilën do të marrë vendim Asambleja e Përgjithshme sipas nenit 18.4, Administratori do të kryejë veprime vetëm mbi bazën e një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme.

18.6 Administratori i parë shoqërisë është ortakun **znj. Alda Mehmetaj**.

## **KREU V**

**Eksperti Kontabël, Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve**

### **NENI 19**

**Eksperti kontabël**

Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një ekspertit kontabël të autorizuar, të emëruar nga Shoqëria.

### **NENI 20**

**Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor**

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor:

Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

### **NENI 21**

**Shpërndarja e Fitimeve**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

**KREU VI**  
**Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë, Largimi dhe Përjashtimi i Ortakëve**

**NENI 22**  
**Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë**

22.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

22.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

**KREU VII**  
**Dispozita të Fundit**

**NENI 23**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

**NENI 24**

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT THEMELUES**

**ALDA MEHMETAJ**

Alda Mehmetaj



**ARIOLA LIKOMETA**

Ariola Likometa

